REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

ASCAP

# OFICERËT E SIGURISË

## Raport vjetor 2020-2021

Qershor, 2021

# 1 HYRJE

OFICERËT E SIGURISË

Raport vjetor

# Hyrje

Oficerët e sigurisë në shkolla janë një qasje e re për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Për herë të parë në sistemin e arsimit parauniversitar oficerët e sigurisë gjejnë hapësirë në periudhën mars-qershor 2018. Gjatë kësaj periudhe, në atë kohe projekt pilot, oficerët e sigurisë u vendosën në 15 gjimnaze të qytetit të Tiranë.

Projekti u pilotua me forca të Policisë së Shtetit, detyrim ligjor që rridhte nga Marrëveshja dypalëshe midis Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Brendshme.

Rezultatet e përftuara mbi rritjen çështjeve të sigurisë në shkollë i hapën rrugën fillimit të procedurave të rekrutimit të oficerëve të sigurisë në shkolla, ku grupi i parë i oficerëve të sigurisë të vendosur në shkolla i përket muajit mars të vitit 2019.

Me anën e VKM-së nr. 600, datë 9.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë”, i ndyrshuar, përcaktohet dhe rregullohet pozicioni i oficerit të sigurisë në shkolla, numri i tyre dhe shpërndarja e tyre në institucionet e arsimit parauniversitar.

Oficerët e sigurisë në shkolla që prej fillesave të tyre janë një frymëmarrje e shtruar rreth çështjeve të sigurisë për institucionet e arsimit parauniversitar.

Dhe pse përvoja e tyre e vogël në vite nuk ishte në anën e tyre, ata ishin nga mbështetësit kryesorë në situatat e krijuara në Shqipëri nga tërmeti i nëntorit të vitit 2019 apo edhe pandemia COVID-19.

Aktualisht në sistemin arsimor parauniversitar janë të punësuar rreth 150 oficerë sigurie që ushtrojnë detyrën e tyre kryesisht në gjimnaze, por edhe në shkolla me drejtim të orientuar, shkolla të mesme të bashkuara apo edhe shkolla profesionale.

2

# METODOLOGJIA

## OFICERËT E SIGURISË
Raport vjetor

# Metodologjia

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar i ka siguruar këto të dhëna nga raportimi i bërë nga procesi i përditshëm i punës së oficerëve të sigurisë.

Një nga format e raportimit të punës së oficerëve të sigurisë është raportimi i incidenteve dhe problematikave të ndryshme nëpërmjet një formular tip raportimi. Këto të dhëna janë hedhur nga oficerët e sigurisë gjatë gjithë vitit shkollor në link-un e krijuar mbi bazën e strukturës së formatit të raportimit të incidenteve dhe problematikave.

Të dhënat që janë analizuar në këtë raport u përkasin raportimeve të bëra nga oficerët e sigurisë për vitin shkollor 2020-2021, mbi incidentet/problematikat që ka konstatuar secili/a në shkollën e tij/saj.



RAPORTI I INCIDENTEVE/ PROBLEMATIKAVE

RRETH 150 OFICERË SIGURIE

4 DRAP

LINK-U ONLINE

51 ZVA


MBLEDHJA E TË DHËNAVE
RAPORTIMI /HEDHJA E TË DHËNAVE
DATABAZA
PËRPUNIMI
RAPORTI

# 3 REZULTATET

## OFICERËT E SIGURISË

### Raport vjetor

## Incidentet/problematikat për çdo DRAP

Shpërndarja e incidenteve/ problematikave të raportuara për çdo Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar



## Incidentet/problematikat për DRAP Durrës

Shpërndarja e incidenteve/ problematikave të raportuara për çdo Zyrë Vendore Arsimore të DRAP Durrës






## Incidentet/problematikat për DRAP Fier

Shpërndarja e incidenteve/ problematikave të raportuara për çdo Zyrë Vendore Arsimorë të DRAP Fier






## Incidentet/problematikat për DRAP Korçë

Shpërndarja e incidenteve/ problematikave të raportuara për çdo Zyrë Vendore Arsimore të DRAP Korçë






## Incidentet/problematikat për DRAP Lezhë

Shpërndarja e incidenteve/ problematikave të raportuara për çdo Zyrë Vendore Arsimorë të DRAP Lezhë



## Incidentet/problematikat për çdo muaj

Shpërndarja e incidenteve/problematikave të raportuara për vitin shkollor 2020-2021




**87**
**TETOR**

**9**
**QERSHOR**

**36.5**
**MESATARJA MUJORE**

49
Shtator
13.4%

Tetor
23.8%
87

50
Nëntor
13.7%

Dhjetor
8.8%
32

2021

# 2021

| Muaji | Numri | Përqindja |
| --- | --- | --- |
| Janar | 28 | 7.7% |
| Shkurt | 28 | 7.7% |
| Mars | 22 | 6% |
| Prill | 22 | 6% |
| Maj | 38 | 10.4% |
| Qershor | 9 | 2.5% |

## Personi i cili konstatoi/raportoi incidentin

Shpërndarja e konstatimeve/raportimeve të incidenteve/problematikave të ndodhura për vitin shkollor 2020-2021




239
OFICERI I SIGURISË

1
BANOR TË ZONËS

## Personi i cili konstatoi/raportoi incidentin



# Lloji i incidenteve/problematikave

Shpërndarja e llojeve të incidenteve/ problematikave të ndodhura për vitin shkollor 2020-2021












## Shpërndarja e llojeve të incidenteve/problematikave



# Ambienti ku ndodhi/konstatua incidenti



## Ndikimi në shëndetin fizik i incidenteve/problematikave

Shpërndarja e incidenteve/problematika sipas ndikimit në shëndetin fizik të individëve të përfshirë.



## Kujt i ka ndodhur incidenti/ problematika?

Shpërndarja e incidenteve/problematikave sipas përkatësisë së të dëmtuarve.




**Nxënësit** 79.5%

**Stafit akademik** 7.4%

**Stafit mbështetës** 4.9%

**Tjetër** 8.2%

## Klasa në të cilën është viktima/i dëmtuari




*Në rastin kur incidenti/problematika i ka ndodhur nxënësit.

## Njerëzit me të cilët ka komunikuar viktima/i dëmtuari

Shpërndarja e rrethit të besimit që ka personi i dëmtuar/viktima mbi incidentin/problematikën e ndodhur.



## Shkaktuesi i incidentit/problematikës

Shpërndarja e incidenteve/problematikave të raportuara sipas shkaktuesit të incidentit.



## Klasa që është shkaktuesi i incidentit/problematikës




*Në rastin kur incidentin/problematikën e ka shkaktuar nxënësi i shkollës.

## Menaxhimi i incidenteve/ problematikave

### Njoftimi i policisë/ambulancës/zjarrfikëses










### Njoftimi/ kontaktimi i prindërve/kujdestarëve






### Hartimi i planit të sigurisë






## Konkluzioni i incidentit/problematikës




*Këto rezultate i referohen të dhënave në momentin e raportimit.

# 4

# KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

## OFICERËT E SIGURISË
## Raport vjetor

# Konkluzione

- Sipas shpërndarjes së incidenteve/problematikave për çdo Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar, përqindjen më të lartë të raportimeve e ka DRAP Durrës me 34% të totalit të raportimeve.

- Zyra Vendore e Arsimit Tiranë me 68 raportime ka numrin më të lartë të raportimeve të incidenteve/problematike për DRAP Durrës.

- Zyra Vendore e Arsimit Fier me 14 raportime ka numrin më të lartë të raportimeve të incidenteve/problematike për DRAP Fier.

- Zyra Vendore e Arsimit Elbasan me 36 raportime ka numrin më të lartë të raportimeve të incidenteve/problematike për DRAP Korçë.

- Zyra Vendore e Arsimit Kukës me 28 raportime ka numrin më të lartë të raportimeve të incidenteve/problematike për DRAP Lezhë.

- Muaji tetor i vitit 2020 është muaji i cili ka më tepër raportime të incidenteve/problematikave për vitin shkollor 2020-2021, përkatësisht 23.8% e totalit të raportimeve të kryera.

- Nga 365 incidente/problematika të raportuara në total, 65.5% (239) e tyre janë konstatuar dhe evidentuar nga oficeri i sigurisë.

- Dhuna fizike është lloji i incidentit/problematikës me shpeshtësinë më të lartë të raportimit, përkatësisht 38.1% e të gjithë raportimeve të kryera.

- Përsa i përket vendndodhjes së incidenteve dhe problematikave, vihet re se peshën më të madhe e zënë incidentet/problematikat që ndodhin jashtë ambienteve të shkollës (119 raportime), pasuar me incidentet që ndodhin në klasë, me apo pa mësuesin (102 raportime).

- 72% e incidenteve/problematikave të raportuara nuk kanë pasur ndikim në shëndetin fizik të personave të dëmtuar.
- Nxënësit zënë 79.5% të personave që iu kanë ndodhur incidentet/problematikat.
- 92% e nxënësve të dëmtuar janë në gjimnaz, ku 118 incidente/problematikave u kanë ndodhur nxënësve të klasës X.
- Oficeri i sigurisë mbetet pika e parë e komunikimit (personi i besuar) në rast incidenti apo problematike nga nxënësit.
- 76.7% e incidenteve/problematikave të raportuara janë shkaktuar nga nxënësit e shkollës.
- 94.6% e nxënësve shkaktues të incidenteve/problematikave janë në gjimnaz, ku 99 incidente/problematika janë shkaktuar nga nxënës të klasës X.
- Për 35% të incidenteve/problematikave të raportuara ka qenë e nevojshme njoftimi i forcave të policisë, ambulancës apo zjarrfikëses.

- Në 87.7% të incidenteve/problematikave të raportuara, janë vendosur në dijeni edhe prindërit.

- Në 80% të incidenteve/problematikave të raportuara ka qenë i nevojshëm hartimi i një plani sigurie për të monitoruar personat e përfshirë.

- 66.6% e incidenteve/problematikave janë zgjidhur plotësisht në momentin e raportimit të tyre. Këto rezultate i referohen të dhënave në momentin të raportimit. Pasi rasti është ndjekur dhe monitoruar nga oficerët e sigurisë këto vlera kanë pësuar ndryshime të mëtejshme.

# Rekomandime

- Të rishikohen formatet e raportimit dhe mënyrat e dokumentimit të punës së oficerëve të sigurisë.
- Të trajnohen oficerët e sigurisë mbi mënyrat e raportimit dhe të dokumentimit të punës së tyre,
- Të hartohen politika dhe programe për shkollat përsa i përket disiplinimit pozitiv, menaxhimit të konfliktit, menaxhimit të klasës, menaxhimit të sjelljes, mendimit kritik, etj.
- Të bëhet një punë më intensive me nxënësit e klasës X që në muajt e parë të fillimit të vitit shkollor, duke qenë se janë shkaktuesit më të lartë të incidenteve/problematikave të ndodhura.

ASCAP

# AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR


sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar